



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1651/6 prot.

Datë 10.06.2026

V E N D I M

Nr. 780/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “R. S. & M Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL*”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “*BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE*”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Ankimues: OE “R. S. & M” Shpk me NUIS K32203002I, me adresë: Tiranë, AUTOSTRAD KM 2,.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, me adresë: Lagjja, “Kushtrimi”, ish Parku i Autobusave, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL*”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “*BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE*”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

II.2. Në datën 04.05.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 12.05.2026 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. " R. S. & M " shpk	5,623,680.00 lekë	I Skualifikuar
2. I.D.K-KONSTRUKSION Sh.p.k	5,635,200.00 lekë	I Kualifikuar

II.4. Në datën 21.05.2026 është publikuar “Njoftim i Fituesit Paraprak” në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 33, datë 25.05.2026, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” Shpk.

II.5. Në datën 26.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1651/2026 protokolli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6723, me statusin e paparaqitur mandat pagesa, e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” Shpk, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ndërsa, ankesa me nr. 1651/1/2026 protokolli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6724, ku u konstatua, se objekti i saj është i njëjti me formular ankesën e sipërcituar, e cila rezulton me statusin e paguar mandat pagesa, e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” Shpk.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1651/2 prot., datë 28.05.2026 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK kundërshton me anë të ankesave me nr. 1651/2026 protokolli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6723 dhe me nr. 1651/1/2026 protokolli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6724.

II.7. Autoriteti Kontraktor ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar, vendimn e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 460/30 prot., datë 03.06.2026, mbi trajtimin e ankesë së ankimuesit, protokolluar me tonën me nr. 1651/3 prot., datë 05.06.2026 ku ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor **nuk e ka pranuar** ankesën.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III. Në datën **26.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike**, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1651/2026 protokoli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6723, me statusin e paparaqitur mandat pagesa, e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” Shpk, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Në datën **26.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike** pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1651/1/2026 protokoli, me datë 26.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6724, ku u konstatua, se objekti i saj është i njëjti me formular ankesën e sipërcituar, e cila rezulton me statusin e paguar mandat pagesa, e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” Shpk. Në kushtet kur, këto dy formularë ankesash të dorëzuara brenda së njëjtës datë dhe me të njëjtin objekt ankesë, Komisioni do ti marrë në shqyrtim pretendimet dhe ankesën e OE “R. S. & M” Shpk, dhe mandat pagesa e paguar brenda afatit nga ana e ankimues vlen për të dyja formularët ankesave, në kushtet kur jemi në të njëjtën procedurë prokurimi dhe me të njëjtin objekt pretendimesh.

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “[...Skualifikohet pasi nuk ka Autorizim Prodhuesi per Kone 750 mm lartesi baza 200mm”], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose te distributorit te autorizuar.

Ne rast se do te paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet te vertetohet lidhje midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite, te nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.1.2. Në shtojcën 6, të DST tek “Grafiku i zbatimit të punimeve”:
Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Nr. analize	Emërtim materiali	Njësia	Sasia
1	An 148	Kornizë artificiale 600 mm x 500 mm h= 5cm	copë	305
2	Man Nr.1	Tubo për tabelat 3m Ø60mm	copë	138

3	“ “	Tabelë ndalim- kalimi fig.47	copë	40
4	“ “	Tabelë drejtimi i detyruar majtas fig. 80/b	copë	9
5	“ “	Tabelë drejtimi i detyruar djathtas fig. 82/c	copë	12
6	“ “	Tabelë rrethrotullimi fig 84	copë	10
7	“ “	Tabelë drejtimi i detyruar drejt fig 80/a	copë	10
8		Tabela parkimi fig76	cope	40
9		Tabela ishullore per ishuj trafiku	cope	20
10		Tabela kembesoresh fig 13	cope	30
11		Tabela Taksi	cope	10
12		Kone 750 mm lartesi baza 200mm	cope	55
13		Tabela trekendore fig 1	cope	20
14		Tabele figura nr 2	cope	10
15		Tabela ndalim parkimi fig 47	cope	20
16		Tabela bicikleta fig 90	cope	24

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj

Afatet e lëvrimit: 7 ditë nga nenshkrimi i minikontratave

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Autorizim prodhuesi nga “MFK PLASTIK A.S. dhe_skede_teknike.pdf për operatorin ekonomik “R. S. & M” SHPK për objektin e procedurës objekt ankimi, produkte të sigurisë rrugore (sinjalizimi horizontal);

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë

proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.4. të DT Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokurimi, duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i

autorizuar, për artikujt objekt prokurimi. Gjithashtu, në rastin kur është paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar, ky autorizim duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi, Autorizim prodhuesi nga “MFK PLASTIK A.S. dhe_skede_teknike.pdf për operatorin ekonomik ofertues “R. S. & M” SHPK për objektin e procedrës objekt ankimi, produkte të sigurisë rrugore (sinjalizimi horizontal).

Në kuptim të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, disponimi i një **autorizimi prodhuesi/** ose Distributori i autorizuar nuk do të thotë thjesht që operatori ekonomik ka një letër nga prodhuesi, por se ai ka një **marrëdhënie të ligjshme dhe të verifikueshme me prodhuesin ose rrjetin e tij të shpërndarjes**, e cila e autorizon të furnizojë mallin objekt prokurimi. Ky dokument përdoret zakonisht për të provuar kapacitetin teknik dhe burimin e furnizimit të mallrave. Nëpërmjet disponimit të dokumentit të kërkuar si “Autorizimi i prodhuesit” ose “Autorizim i Distributorit të autorizuar”, zakonisht provon se: operatori ekonomik është i autorizuar të tregtojë ose furnizojë produktin e prodhuesit ose Distributori i autorizuar; Malli do të vijë nga një burim zyrtar dhe i gjurmueshëm; Prodhuesi ose Distributori i autorizuar njeh operatorin ekonomik si partner, distributor ose përfaqësues të tij; Ekziston mundësia reale e furnizimit të mallrave të kërkuara gjatë zbatimit të kontratës.

Në rast nevojë, autoriteti kontraktor mund të verifikojë autenticitetin e produktit dhe të autorizimit pranë prodhuesit ose Distributori i autorizuar. KPP sqaron se, disponimi i dokumentit si “Autorizimi i prodhuesit”/“Autorizim nga Distributori i autorizuar”, **nuk provon** se: Malli është prodhuar sipas një standardi të caktuar; Malli i ofruar është pikërisht modeli i kërkuar në tender; Malli i plotëson specifikimet teknike të tenderit; Malli është prodhuar tashmë ose është në magazinë; Operatori ka ekskluzivitet mbi produktin. Për këto kërkokohen dokumente të tjera si certifikata konformiteti, datasheet, raporte testimi, certifikata EN, katalogë teknikë/fletë teknike të produktit. Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor se operatori ekonomik ankimues nuk disponon “Autorizim prodhuesi” për mallin “Kone 750 mm lartësi dhe baza 200mm”, mall objekt prokurimi, nuk qëndron pasi ankimuesi e disponon një dokument Autorizim prodhuesi nga “MFK PLASTIK A.S. dhe_skede_teknike.pdf për operatorin ekonomik ofertues “R. S. & M” SHPK për objektin e procedrës objekt ankimi, produkte të sigurisë rrugore (sinjalizimi horizontal). Në kushtet kur autoriteti kontraktor kërkon në DT disponimin e një dokumenti si “Autorizimi i prodhuesit”/“Autorizim nga Distributori i autorizuar”, autoriteti kontraktor duhet të verifikojë nëse autorizimi është lëshuar nga vetë prodhuesi ose distributor i autorizuar; nëse autorizimi mbulon mallin objekt prokurimi; nëse është i vlefshëm në kohën e ofertimit; nëse identifikohet qartë prodhuesi dhe operatori ekonomik; nëse, kur autorizimi jepet nga distributori, provohet lidhja e distributorit me prodhuesin, etj.

KPP gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për përmbushjen e kriterit më sipër, është i vlefshëm dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Sa më sipër, Komisioni gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, operatori ekonomik ankimues e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “R. S. & M” ShPK qëndron .

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R. S. & M” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *“[...Nga vlersimi i mostrave u konstatua se zeri 12 Kone me lartesi 750mm dhe baze 200mm nuk eshte sipas specifikimeve te kerkuara ne DST perkatesishte Kone i paraqitur n ga Operatori eshte 750mm lartesi dhe 420 mm baza”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5:

“2.3.5 Në menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik duhet te paraqese mostra për mallrat objekt prokurimi me numer rendor 1, 8, 12(referoju artikujve sipas shtojcës 7)

Ky kriter I shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe cilësisë që ato duhet të kenë.”

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.4. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, ndryshuar me udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

“Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon

në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.”

III.2.5. Në nenin 80 pika 1,2,3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”

III.2.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.2.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet

apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.10. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

III.2.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë

pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.12. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, kemi kriterin 2.3.5 të DT, sipas së cilit *“Në menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik duhet te paraqese mostra për mallrat objekt prokurimi me numer rendor 1, 8, 12, (referoju artikujve sipas shtojcës 7). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe cilësisë që ato duhet të kenë.* Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor (Vendimi i KSHA me nr. 460/30 prot., datë 03.06.2026), KPP gjykon se, autoriteti kontraktor me të drejtë ka skualifikuar operatorin ekonomik “R. S. & M” ShPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, komponentët e kërkuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcën nr.7 *“Formulari I Sasisë Dhe Grafikut Të Lëvrimit”* për artikullin me nr.rendor 12, *“Kone 750 mm lartesi baza 200mm”*, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Referuar mostrës së paraqitur të ankimuesit në autoritet kontraktor si dhe skedës teknike (datasheet) të këtij artikulli në SPE, konstatohet se, bKone është me lartësi 750 mm dhe me bazë 430 mm. Për më tepër, gjatë fazës së publikimit të dokumentave të tenderit për këtë procedurë, nuk ka patur ankesa nga operatorë ekonomikë apo nismën nga vetautoritetit kontraktor, mbi përmbushjen e këtij kriteri. Gjithashtu, Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e

veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme, për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor (Vendimi i KSHA me nr. 460/30 prot., datë 03.06.2026), mostra Kone me 750 mm lartesi baza 430mm, nuk konsiderohet se është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "R. S. & M" ShPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht, ankesën e operatorit ekonomik "R. S. & M" SHPK, për procedurën e prokurimit "*Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL*", me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt "*BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE*", me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik " R. S. & M" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë ofertues.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik " R. S. & M" SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

